

PERMBLEDHJE

Termet dhe Kushtet

- Klienti është personi fizik i cili regjistrohet në EasyPay për të marrë nga platforma të gjitha shërbimet sipas kontratës midis palëve [“Kontrata Elektronike”](#).
- Kontrata interpretohet në përputhje me Ligjin Nr. 10 128, datë 11.5.2009 “Për Tregtinë Elektronike” (i ndryshuar), Ligji Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Platforma EasyPay nuk lejohet të përdoret nga persona nën moshën 18 vjeç ose nga çdo person tjetër i ndaluar apo i përjashtuar më parë nga përdorimi i platformës.
- Klienti gjatë fazës së regjistrimit duhet të plotësojë saktë të dhënat e tij personale.
- Klienti është përgjegjës për ruajtjen e fshehtësisë e fjalëkalimit të tij. Në rast të vjedhjes së fjalëkalimit, ai duhet të kontaktojë menjëherë EasyPay.
- Klienti duhet të japë informacione të plota, të sakta e të përditësuara.
- Klienti përpara se të mbyll fazën e regjistrimit pranon të gjitha kushtet e kontratës elektronike ku përcaktohen qartë baza ligjore, termat, përgjegjësitë e palëve, të drejtat e detyrimit, politikat e informacionit konfidencial, trajtimi i mashtrimit etj.
- Pasi ai të ketë plotësuar këto kushte, bëhet regjistrimi përfundimtar në platformë.
- EasyPay mbron të të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, nga aksesit ose përhapja nga persona të paautorizuar, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me masat e përshtatshme tekniko-organizative të shoqërisë.
- Klientët e EasyPay nuk paguajnë asnjë tarifë apo komision regjistrimi e mirëmbajtje llogarie.
- Të gjitha transaksionet kryhen në monedhën Lekë (ALL) dhe klienti duhet të ketë balancë në llogarinë e tij EasyPay për të kryer transaksione.
- Në rastet kur EasyPay nuk është e bindur për vërtetësinë e të dhënave të identitetit të klientit, dhe kur ky i fundit nuk i përgjigjet kërkesave për të dhëna shtesë lidhur me identitetin e tij, atëherë EasyPay nuk lejon kryerjen e transaksioneve. Këto kufizime hiqen menjëherë sapo të verifikohen të dhënat nga EasyPay.
- Ndryshimet pasqyrohen në faqen tonë zyrtare, në aplikacion dhe nëpërmjet njoftimeve në rrjete sociale. Ata njoftohen për oferta që mund të përfitojnë në rast se janë klientë besnik apo nëse kryejnë një numër të caktuar transaksione mujore të suksesshme. Në çdo fushatë promovionale për lançimin e një shërbimi të ri apo ndryshime në shërbime ekzistuese, klientëve u dergohet e-mail njoftues.
- Me synim fokusin tek klienti, për herë të parë në Shqipëri, EasyPay ofron shërbime shtesë. Me aprovimin nga klienti, ata njoftohen në mënyrë periodike për detyrime të papaguara dhe mënyrat e pagesës.